

L I G J
Nr. 7962, datë 13.7.1995

PËR ENERGJINË ELEKTRIKE
(Ndryshuar me ligjin nr. 8679, datë 2.11.2000)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të përmirësojë dhe të nxitë efektivitetin ekonomik dhe cilësinë e shërbimeve në veprimtarinë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, duke siguruar interesin publik.

Neni 2

Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon kushtet e veprimtarisë në sektorin e energjisë elektrike, të drejtat dhe detyrat e personave fizikë a juridikë si dhe të administratës shtetërore.

Neni 3

Fusha e veprimtarisë

Veprimtari në sektorin e energjisë elektrike, në territorin e Republikës së Shqipërisë, me kushtet e përcaktuara nga ky ligj, mund të ushtrojë persona fizikë a juridikë vetëm në bazë të licencës të dhënë nga Enti i Rregullimit të Sektorit të Energjisë Elektrike.

Neni 4

Enti i Rregullimit të Sektorit të Energjisë Elektrike

Krijimi dhe detyrat e entit të Rregullimit të Sektorit të Energjisë Elektrike caktohen me ligj të veçantë.

Neni 5

Periudha tranzitore

Gjatë periudhës tranzitore deri sa Enti i Rregullimit të marrë funksionet e plota të tij në përputhje me “Ligjin e Rregullimit”, zbatimi i këtij ligji do të ushtrohet nga ministri i Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, i cili do të kryejë funksionet e Kryetarit të Entit të Rregullimit vetëm për periudhën tranzitore, kohë e cila caktohet me vendim të Këshillit të

Ministrave.

Neni 6

Transformimi i KESH-it në Shoqëri Anonime (SHA)

Në zbatim të ligjit të shndërrimit të ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare, Këshilli i Ministrave bën riorganizimin e sektorit të energjisë elektrike.

Personat juridikë që do të kryejnë veprimtari në sektorët e energjisë elektrike, pas ristrukturimit të tyre do të pajisen me licenca shtetërore.

Licenca do të jepet sipas nenit 3 të këtij ligji, pasi në vendimin e Këshillit të Ministrave për transformimin e funksioneve të KESH-it janë përcaktuar:

(1) Kur jepet një licencë sipas nenit 3 të këtij ligji, pas konsultimit me Entin e Rregullimit dhe nëpërmjet një skeme transformimi, mund t'i japë marrësit të licencës;

(a) pronat, të drejtat, aktivet e pasivet, me të njëjtat kushte dhe afate që i përkasin KESH-it deri në datën kur skema e transferimit bëhet efektive, siç mund të jetë rënë dakord ndërmjet Qeverisë, KESH-it dhe marrësit të licencës;

(b) çdo të drejtë dhe kompetencë të ushtruar deri atëherë nga KESH-i, të cilën Qeveria e shikon të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë me të cilën marrësi i licencës është ngarkuar;

(c) personelin punonjës.

(2) Qeveria, mbas konsultimit me një mbajtës licence shtetëror (por jo me një mbajtës licence privat) kërkon nga mbajtësi ekzistues i licencës të hartojë një skemë transferimi për t'i dhënë një marrësi licence të mëvonshëm prona, të drejta, pasive dhe personel punonjës, të cilat kanë qënë mbajtur nga mbajtësi i licencës, në përputhje me paragrafin (1).

(3) Një skemë transferimi duhet të përmbajë:

(a) përcaktimin e pronës, të drejtat dhe pasivet që do t'i jepen një marrësi licence të veçantë:

i) duke specifikuar ose përshkruar pronën, të drejtat dhe pasivet në fjalë;

ii) duke iu referuar të gjithë pronës, të drejtave dhe pasiveve të përfshira në një pjesë të veçantë të poseduar nga mbajtësi i licencës;

iii) ose pjesërisht me njërën mënyrë dhe pjesërisht në mënyrën tjetër.

(b) Parashikimin që disa të drejta ose pasive të specifikuara apo të përshkruara në skemë do të jenë të detyrueshme për një apo më shumë marrës licence;

(c) detyrimin që të ngarkojë çdo marrës licence për të hyrë në marrëveshje me shkrim apo të ekzekutojë dokumente të tjera në favor të ndonjë marrësi licence tjetër siç është specifikuar në skemë;

(d) parashikime plotësuese të vogla e të parëndësishme që mbajtësi i licencës i konsideron të vlefshme (duke përfshirë parashikime që specifikojnë rregullin, në të cilin ndonjë transferim apo transaksion duhet të merret në konsideratë).

(4) Të gjitha borxhet dhe detyrimet ekzistuese, kontratat e lidhura si dhe të gjitha çështjet e tjera në këtë fushë, të marra përsipër për t'u zbatuar nga KESH-i, do t'i ngarkohen marrësit të licencës në masën e specifikuar në skemën përkatëse të transferimit; këto do të jenë detyrim për t'u zbatuar nga marrësi i licencës. Të gjitha kushtet dhe procedurat e tjera legale, të caktuara pro ose kundër KESH-it, do të vazhdojnë nga marrësi i licencës pro ose kundër tij. Këto vlejnë edhe për një të licensuar në kushtet e parashikuara në paragrafin (2).

(5) Në rast se marrësit të licencës i kërkohet t'i kalojë një pjesë e angazhimeve të tij një marrësi licence tjetër, në përputhje me paragrafin (2), Enti i Rregullimit do të ndryshojë licencën e marrësit të licencës në përputhje me nenin (21) të ligjit të rregullimit apo të revokojë licencën e tij në përputhje me këtë ligj, në mënyrë që të sigurojë që marrësi i licencës të mos shkelë asnjë prej kushteve të licencës së tij si rezultat i skemës së transferimit.

(6) Një skemë transferimi sipas paragrafit (1) ose (2) do të hyjë në fuqi në datën kur

Qeveria do ta bëjë të ditur zyrtarisht.

(7) KESH-i do të pushojë dhe nuk do të ushtrojë më funksionet dhe detyrat e specifikuar në paragrafin (1) (b) që nga momenti kur ato i jepen një marrësi licence.

(8) Ushtrimi i çdo të drejte apo komeptence të KESH-it nga një marrës licence mund të bëhet në kushte që do të specifikohen në rregullin e vendosur për marrjen e licencës.

Neni 7

Ndryshimi i transferimeve me marrëveshje

Në çdo kohë përpara mbarimit të periudhës prej 12 muajsh, duke filluar nga data që skema e transferimit të bërë në përputhje me paragrafin (1) ose (2) të nenit (6) bëhet efektive, marrësi i licencës, pronat, të drejtat, aktivet dhe ose punonjësit e të cilit kanë qënë transferuar, me lejen e Qeverisë (ose Entit të Rregullimit), mund të ndërtojë një skemë transferimi për të autorizuar disa apo të gjithë pronën, të drejtat, aktivet, pasivet dhe punonjësit në një marrës licence tjetër, duke siguruar që këto të merren përsipër për t'u zbatuar. Ndonjë nga këto skema transferimi do të hyjë në fuqi siç është parashikuar në skemën e transferimit sipas nenit (6).

PJESA E DYTË

Neni 8

Gjendja e jashtëzakonshme në furnizimin me energji elektrike

(1) Gjendje e jashtëzakonshme për qëllime të këtij ligji kuptohet kufizimi ose ndërprerja e furnizimit me energji elektrike, për një kohë më të gjatë se 48 orë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose në pjesë të saj si pasojë e:

- a) forcave madhore;
- b) masave të organeve shtetërore për gatishmërinë mbrojtëse të shtetit;
- c) avarive në pajisjet e prodhimit transmetimit e shpërndarjes së energjisë elektrike;
- d) mungesës për kohë të gjatë të burimeve të energjisë elektrike;
- e) situatave të veçanta të ndotjes së mjedisit konform rregullave të posaçme; (shiko “Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit”)
- f) akteve terroriste.

(2) Gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme mbajtësit e licencës dhe përdoruesit janë të detyruar të respektojnë kufizimin e përdorimit të energjisë elektrike. Masën dhe mënyrën e kufizimit të përdorimit e vendos Ministria me udhëzim të veçantë.

(3) Gjendjen e jashtëzakonshme për gjithë territorin e shtetit e shpall Qeveria me njoftim në mjedise publike. Kur është fjala për gjendje të jashtëzakonshme vetëm për pjesë të territorit të shtetit atë e shpall ministri.

(4) Mbajtësit e licencës janë të detyruar që menjëherë pas lindjes së avarisë apo shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme të fillojnë likuidimin e pasojave në përputhje me planet e likuidimit të avarisë sipas fondeve të dhëna nga Këshilli i Ministrave.

(5) Kur si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme ndodhin ndërprerje serioze të furnizimit me energji elektrike, sidomos gjatë avarive të përhapura në pajisjet e prodhimit, transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, mbajtësit e licencës, kur lejojnë kushtet e tyre teknike, janë të detyruar të marrin pjesë në likuidimin e avarisë dhe rivendosjen e furnizimit.

(6) Mënjanimi i avarisë dhe rivendosja e furnizimit sipas paragrafit të mësipërm drejtohet nga Ministria, udhëzimet e së cilës janë të detyruara t'i përmbushin mbajtësit e licencës.

(7) Ecurinë gjatë shfaqies dhe likuidimit të pasojave të gjendjes së jashtëzakonshme e vendos Ministria me qarkore.

PJESA E TRETË DREJTIMI OPERATIV DHE TEKNIK

Neni 9 **Drejtimi dispeçer**

(1) Ekuilibrin ndërmjet burimeve dhe përdorimit të energjisë elektrike dhe punimin e sigurtë e të qëndrueshëm të sistemit elektroenergjetik do ta sigurojë dispeçeria.

(2) Sistem elektroenergjetik për qëllimet e këtij ligji kuptohet lidhja reciproke e kompleksit të pajisjeve për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, përfshirë lidhjet elektrike dhe pajisjet elektrike që përdoren në sistemin e drejtimit, të teknikës së mbrojtjes e të matjes dhe pajisjeve të transmetimit të informacionit për veprimtarinë tekniko-ekonomike (financiare) dhe sistemeve informative.

(3) Furnizuesit, të cilët shfrytëzojnë pajisje shpërndarëse të një pjese të sistemit elektroenergjetik, kanë dispeçeritë e tyre rajonale dhe janë të detyruar të përballojnë shfrytëzimin e dispeçerive përkatëse me shpenzimet e veta.

(4) Sistemin elektroenergjetik të Republikës së Shqipërisë e drejton Dispeçeria Qendrore Elektroenergjetike (Dispeçeria Qendrore).

(5) Dispeçeria Qendrore do të sigurojë:

a) drejtimin unik të sistemit elektroenergjetik duke përfshirë edhe shpalljen e shkallëve të përdorimit gjatë avarive në pajisjet e prodhimit, transmetimit e të shpërndarjes dhe gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme;

b) bashkëpunimin ndërkombëtar në import-eksportin e energjisë elektrike;

c) shfrytëzimin efektiv të burimeve në fuqi 50 MW e lartë, pajisjeve transmetuese me tension 400 kV dhe 220 kV dhe pajisjeve transmetuese të zgjedhura 110 kV.

(6) Rregullat e drejtimit dispeçer i vendos “Rregullorja Dispeçer”, të cilën e miraton Enti i Rregullimit. Rregullorja Dispeçer rregullon përgatitjen e shfrytëzimit të sistemit dhe drejtimin operativ të tij, analizën, kontrollin dhe vlerësimin e përfundimeve dhe dhënien e informacionit unik në sistem gjatë punimit normal dhe në gjendjet e jashtëzakonshme.

(7) Mbajtësit e licencës dhe personat e tjerë fizikë a juridikë janë të detyruar të respektojnë udhëzimet e Dispeçerisë përkatëse në përputhje me përmbajtjen e këtij ligji dhe të Rregullores Dispeçer të miratuar.

(8) Mbajtësit e licencës janë të detyruar t’i njoftojnë Dispeçerisë Qendrore dhe Ministrisë për situatat sipas nenit 8 të paragrafit të parë a), c), e) dhe f), menjëherë pas shfaqjes së saj.

Neni 10 **Furnizimi me energji elektrike**

(1) Mbajtësi i licencës për shpërndarje (furnizuesi) është i detyruar t’i sigurojë dhënien e energjisë elektrike çdo personi fizik a juridik (përdoruesi) i cili:

a) bën marrëveshje paraprake për furnizim me energji elektrike, kur kjo teknikisht është e mundur dhe ndodhet në vendin e veprimtarisë së autorizuar;

b) ka pëlqimin e organeve përkatëse;

c) plotëson kushtet lidhur me vendin, mënyrën dhe afatin e lidhjes së vendosur nga furnizuesi;

d) ka bërë lidhjen elektrike me pajisjet elektrike marrëse në përputhje me normat teknike dhe rregullat ligjore të sigurisë në punë.

(2) Për dhënien e energjisë elektrike furnizuesi lidh me përdoruesin kontratë me shkrim

për çdo vend-marrjeje, e cila duhet të përmbajë:

a) fuqinë, ecurinë sasiore e kohore të marrjes së energjisë elektrike (më poshtë “diagrama e përdorimit”), kjo edhe për gjendjet e jashtëzakonshme;

b) çmimin dhe mënyrën e pagesës së energjisë elektrike që merr sipas dispozitave ligjore në fuqi.

c) mënyrën e matjes së energjisë elektrike që merret, përfshirë edhe mundësinë e hyrjes së furnizuesit të pajisjet e matjes.

(3) Marrëveshja për diagramën e përdorimit nuk kërkohet për përdoruesit në rrjetin e tensionit të ulët.

(4) Përdoruesi është i detyruar:

a) të sigurojë që pajisjet e tij përdoruese që lidhen me impiantet shpërndarëse të furnizuesit të jenë të paisura me mjetet teknike të nevojshme, që kufizojnë ndikimin e veprimit të anasjelltë mbi cilësinë e energjisë elektrike, e cila u është furnizuar përdoruesve të tjerë dhe të mos ndikojë mbi funksionin e komandimit, matjes, teknikës së mbrojtjes dhe mbi veprimin e sistemit të përbashkët të telekomandimit;

b) të marrin energji elektrike me vlerë koeficienti të fuqisë 0.95-1.0, derisa midis përdoruesit dhe furnizuesit nuk është vendosur ndryshe, me përjashtim të përdoruesve shtëpiakë; mënyra e konstatimit dhe e vlerësimit të këtij treguesi vendoset nga Enti i Rregullimit me udhëzim të veçantë.

(5) Përdoruesi mund të vërë në punë burime të veta rezervë ose burime të tjera, kur është i lidhur me pajisjet shpërndarëse të furnizuesit, si dhe të japë energji elektrike nga burimet vetjake në këto pajisje, vetëm pas marrëveshjes së bërë me shkrim me furnizuesin.

(6) Në pajisjet elektrike përdoruese nëpër të cilat kalon energji elektrike e pamatur, nuk mund të bëhet asnjë ndërhyrje pa pëlqimin paraprak të furnizuesit.

(7) Furnizuesi nuk bën lidhjet elektrike nëse impiantet elektrike përdoruese nuk u përgjigjen normave teknike dhe rregullave ligjore të sigurimit teknik.

(8) Përdoruesi sipas madhësisë së fuqisë që përdor, merr pjesë në shpenzimet që furnizuesi bën për lidhjen dhe sigurimin e fuqisë së kërkuar, në masën e llogaritur sipas mënyrës së caktuar me udhëzim të veçantë nga Enti i Rregullimit.

(9) Përdoruesi është i detyruar që pajisjet elektrike marrëse t’i mbajë në gjendje që i përgjigjen normave teknike dhe dispozitave ligjore të sigurimit teknik dhe t’i japë furnizuesit të dhëna teknike për to.

(10) Kur ndrohet tensioni për interes të zhvillimit teknik, poseduesit e pajisjeve marrëse të lidhura dhe konsumatorët janë të detyruar të përballojnë me shpenzimet e veta shpenzimet e kthimit të pajisjeve përdoruese dhe konsumatorëve, në përputhje me ndryshimet e bëra dhe brenda afateve të rakorduara, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në kontratë.

(11) Rregullat e hollësishme për mirëmbajtjen dhe furnizimin me energji elektrike bëhen me udhëzim të veçantë nga Enti i Rregullimit.

(12) Furnizuesi ka të drejtë ta kufizojë ose ndërpresë në përmasat e nevojshme dhënien e energjisë elektrike në këto raste:

a) kur ka kërcënime direkte të jetës, shëndetit apo pasurisë së personave;

b) në gjendjen e jashtëzakonshme sipas nenit 8, paragrafi 1, ose në veprimtarinë direkte parandaluese të lindjes së tyre;

c) gjatë zbatimit të remonteve të planifikuara, mirëmbajtjes dhe punëve të revizionit;

d) kur lindin e mënjanohej difekte në pajisjet e shpërndarjes së energjisë elektrike (më poshtë “pajisje shpërndarëse”);

e) kur kryhen veprime të domosdoshme shfrytëzimi dhe në këto raste jo më gjatë se 30 minuta;

f) kur marrja e energjisë elektrike bëhet në mënyrë të parregullt siç jepet në nenin 17

paragrafi (1), të këtij ligji;

g) kur përdoruesi gjatë marrjes së energjisë elektrike përdor pajisje, të cilat rrezikojnë jetën, shëndetin apo pronën e personave;

h) kur përdoruesi gjatë marrjes së energjisë elektrike përdor pajisje të cilat ndikojnë në cilësinë e energjisë elektrike në dëm të përdoruesve të tjerë dhe nuk janë zbatuar masat teknike të duhura për mënjanimin e këtij ndikimi;

i) kur jepen porosi nga shërbimi dispeçer sipas nenit 9 paragrafi 7.

(13) Në rastet e përmendura në paragrafin 12, gërma “c” furnizuesi është i detyruar të njoftojë fillimin dhe mbarimin e kufizimit ose ndërprerjes së furnizimit të energjisë elektrike me mënyrën e zakonshme të lajmërimit, të paktën 15 ditë përpara.

(14) Në rastet e përmendura në paragrafin (12) furnizuesi është i detyruar të rijapë furnizimin me energji elektrike pas mënjanimin të shkaqeve të cilat çuan në kufizimin apo ndërprerjen e saj. Në qoftë se kohëzgjatja e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike është më e madhe se normat teknike të vendosura nga enti rregullues, furnizuesi detyrohet t’i përgjigjet përdoruesit sipas kushteve të parashikuara në kontratën midis tyre.

(15) Brenda një muaji pas dhënies së licencës mbajtësi i saj është i detyruar të përpunojë planin e likuidimit të avarive dhe të zgjidhjes së gjendjeve të jashtëzakonshme dhe t’ia paraqesë atë Ministrisë; kjo nuk kërkohet për prodhuesit e energjisë elektrike me fuqinë e instaluar më të vogël se 10 MW.

(16) Furnizuesi ka të drejtë:

a) të hyjë dhe të kalojë nëpër pronat e të tjerëve që lidhen me shfrytëzimin, meremetimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të tij shpërndarëse;

b) të heqë dhe të krasisë pemët dhe bimësitë e tjera të larta që kërcënojnë shfrytëzimin e sigurtë e të përshtatshëm të pajisjeve shpërndarëse në rastet kur, pas një njoftimi paraprak, këtë punë nuk e ka kryer vetë pronari ose përdoruesi;

c) të vendosë e të shfrytëzojë rrjetin e vet të telekomunikimit për drejtimin, matjen, mbrojtjen dhe automatizimin e shfrytëzimit të sistemit elektrik, si dhe për transmetimin e informacionit për veprimtarinë financiare dhe të sistemeve informative;

d) në përputhje me rregullat specifike të çdo sektori, të hyjë në teritoret e mbyllura dhe në pajisjet që shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë dhe në shërbimet e organeve të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe në pajisjet e shfrytëzimit të hekurudhave, si dhe të hyjë në prona ku janë vendosur pajisje të veçanta të telekomunikacionit, në përmasa dhe mënyra të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së licensuar;

e) për gjendjen e jashtëzakonshme të përdorë në masën e duhur pajisjet marrëse të përdoruesve.

(17) Gjatë kryerjes së riparimeve sipas paragrafit të mësipërm, furnizuesi është i detyruar të ruajë sa më tepër të drejtat e poseduesve të pronave të prekura dhe t’u njoftojë atyre hyrjen në territorin e tyre. Pas përfundimit të punimeve ai është i detyruar ta sjellë pronën në gjendjen e mëparshme.

(18) Kur pronarit apo qeraxhiut të pasurisë të paluajtshme, si pasojë e zbatimit të të drejtave të furnizuesit sipas paragrafit (16), i bëhen dëmtime në pronësi ose i shkaktohen kufizime në përdorimin e zakonshëm të pronës së paluajtshme, ai ka të drejtën e kompensimit të njëhershëm. Detyrimin për këtë kompensim duhet ta paguajë furnizuesi, i cili ka shkaktuar dëmin e pronës ose kufizimin e përdorimit të pasurisë së paluajtshme, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

(1) Lidhja elektrike fillon me degëzimin prej impjantit shpërndarës në drejtim të përdoruesit dhe përfundon në lidhjen e pajisjeve elektrike marrëse të një përdoruesi.

(2) Në stacionin elektrik lidhja elektrike fillon nga elementet komutues ose lidhës, jashtë centralit elektrik fillon nga linja ajrore apo kablllore.

(3) Lidhja elektrike e tensionit të ulët përfundon për linjat ajrore te kaseta kryesore e siguresave të shtëpisë, ndërsa për linjat kablllore te kaseta kryesore kablllore e shtëpisë. Këto kaseta janë pjesë e lidhjes. Kaseta kryesore e siguresave të shtëpisë apo kaseta kryesore kablllore e shtëpisë vendoset në objektin marrës ose në kufirin apo në afërsi të pronës së paluajtshme të tij.

(4) Kur kaseta kryesore e siguresave të shtëpisë nuk është në pronën e paluajtshme të përdoruesit, lidhja ajrore e tensionit të ulët përfundon në pikën fundore mbështetëse në pronën e paluajtshme të shtëpisë. Pika mbështetëse është pjesë e lidhjes.

(5) Kur kaseta kryesore kablllore e shtëpisë nuk është në pronën e e paluajtshme të përdoruesit, lidhja elektrike e tensionit të ulët përfundon në bornat e çelësit kryesor të pajisjes marrëse ose në kasetën kablllore brenda objektit të përdoruesit.

(6) Lidhja elektrike e tensionit të lartë dhe shumë të lartë për linjat ajrore përfundon tek izolatorët mbështetës të stacionit përdorues, për linjat kablllore te koka e kabllit të stacionit përdorues. Izolatorët mbështetës dhe koka e kabllit janë pjesë e lidhjes.

(7) Shpenzimet për kryerjen e lidhjes elektrike i përballon ai për të cilin bëhet kjo lidhje, nëse ky ligj nuk parashikon ndryshe.

(8) Shpenzimet për kryerjen e lidhjes së tensionit të ulët për furnizimin shtëpiak deri në largësi 30 metra i përballon furnizuesi, me kusht që përdoruesi t'i ketë kryer punimet e tij brenda kushteve teknike të një lidhjeje të tillë.

(9) Pronar i lidhjes është ai që ka bërë shpenzimet për ndërtimin e saj.

(10) Pronari i lidhjes elektrike është i detyruar të sigurojë funksionimin, mirëmbajtjen dhe riparimet e saj, në mënyrë të tillë që të mos bëhet shkak rreziku për jetën e shëndetin apo dëmtimin e pasurisë së personave.

(11) Furnizuesi është i detyruar kundrejt pagesës të mbajë në funksionim, mirëmbajë e riparojë lidhjen elektrike kur kjo kërkohet nga pronari i saj.

Neni 12

Matja e energjisë elektrike

(1) Energjia elektrike e përdorur matet e faturohet nga furnizuesi sipas të dhënave të pajisjes matëse të furnizuesit. Vendosja, lidhja, mirëmbajtja dhe verifikimi i saktësisë së matjes bëhen nga furnizuesi me shpenzimet e tij. Transformatorët e matjes janë pjesë e pajisjes matëse.

(2) Kur përdoruesi ka dyshime mbi saktësinë e të dhënave të matjes apo konstaton të meta në pajisjet matëse, ka të drejtë të kërkojë kontrollimin e saj. Furnizuesi në bazë të kërkesës me shkrim të përdoruesit, është i detyruar për këtë qëllim të ndrojë pajisjen matëse deri 15 ditë pas marrjes së kërkesës. Përdoruesi është i detyruar t'i japë furnizuesit ndihmën e duhur për ndrimin e pajisjes matëse.

(3) Kur në pajisjet matëse konstatohet difekt, shpenzimet e ndrimit dhe të kontrollit të saj, i mbulon furnizuesi. Kur nuk konstatohet defekt këto shpenzime i përballon përdoruesi.

(4) Çdo lloj ndërhyrjeje në pajisjet matëse pa pëlqimin e pronarit të saj ndalohet dhe ndëshkohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

(5) Furnizuesi duhet të sigurojë çdo pjese të veçantë të pajisjes matëse për të parandaluar ndërhyrje të paautorizuara.

(6) Furnizuesi është i detyruar të sigurojë matjen e duhur për të gjithë konsumatorët brenda një periudhe kohe që do të përcaktohet nga Enti i Rregullimit. Shpenzimet do të përballohen nga furnizuesi dhe do të llogariten si kosto shërbimi.

Neni 13

Blerja e energjisë elektrike nga burime dytësore dhe të rinovueshme

(Ndryshuar fjalë në titull dhe në paragrafin e parë të shkronjës “b”, shtuar paragraf në shkronjën “b” të pikës 1 dhe nënparagrafët “a”, “b”, “c” në pikën 4 me ligjin nr. 8679, datë 2.11.2000)

(1) Furnizuesi është i detyruar, përsa kjo është e mundshme teknikisht, ta blejë energjinë elektrike:

a) nga prodhimi i kombinuar i nxehtësisë dhe energjisë elektrike në përmasa që i përgjigjen nevojës teknologjike të prodhimit të nxehtësisë;

b) nga prodhimi i burimeve të rinovueshme dhe nga burime të tjera.

Burime të rinovueshme janë:

- energjia diellore në të gjitha aplikimet e saj;
- energjia e erës;
- energjia gjeotermike e të gjitha llojeve;
- energjia hidrike;
- energjia e biomasës në të gjitha aplikimet e saj.

(2) Shpenzimet për lidhjen e burimeve sipas paragrafit (1) i mbulon pronari i kësaj pajisjeje.

(3) Mënyrën e lidhjes së burimeve me pajisjet e shpërndarjes sipas paragrafit (1) e përcakton furnizuesi.

(4) Furnizuesi e blen energjinë elektrike me çmim sipas marrëveshjes së bazuar në rregulloren e çmimeve të Entit të Rregullimit.

a) Duke filluar nga 1 janari 2001, furnizuesi dhe të gjithë prodhuesit e tjerë të pavarur të energjisë elektrike mbi 2 MW janë të detyruar të prodhojnë, për sistemin elektroenergjitik shqiptar, energji elektrike nga burime të energjive të rinovueshme, në masën 2 për qind të të gjithë sasisë së energjisë elektrike të prodhuar prej tyre nga burime të tjera.

b) Detyrimi i mësipërm vlerësohet i plotësuar edhe duke blerë kuotën e njëvlefshme të energjisë elektrike nga prodhues të tjerë vendas ose duke e importuar nga vende të tjera. Ky detyrim vlerësohet i përmbushur kur Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dokumenton se energjia elektrike e importuar është e prodhuar nga burime të rinovueshme.

c) Në rastet e mosplotësimit të këtij detyrimi, Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike ka të drejtë të gjobisë në masën 50-100 për qind të vlerës së këtij detyrimi, si dhe të ndalojë ushtrimin e veprimtarisë së tyre, përsa kohë që ata të plotësojnë këtë detyrim.

Neni 14

Zonat e mbrojtjes

(1) Pajisjet për prodhimin e energjisë elektrike, të transmetimit si dhe pajisjet e shpërndarjes mbrohen nga zonat mbrojtëse.

(2) Zonë mbrojtëse për qëllime të këtij ligji kuptohet hapësira në afërsi të drejtpërdrejtë të pajisjes prodhuese, transmetuese dhe asaj shpërndarëse, e destinuar për sigurimin e punimit të sigurtë të tyre dhe për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pasurisë së personave.

(3) Me zona mbrojtëse mbrohen linjat elektrike ajrore, nëntokësore dhe stacionet elektrike.

(4) Zona mbrojtëse e linjës ajrore kufizohet me sipërfaqe pingule nga dy anët e linjës në largësi horizontale perpendikulare me linjën, e cila nga përcjellësi anësor i linjës në çdo anë të saj është:

a) në tension mbi	1 kV	deri	35 kV	përfshirë	10 m
-------------------	------	------	-------	-----------	------

b) ““““	35 kV	“	110 kV	“	15 m
c) ““““	110 kV	“	220 kV	“	20 m
ç) ““““	220 kV	“			25 m
d) ““““	400 kV				35 m

(5) Në pyje pronarët dhe shfrytëzuesit e tyre janë të detyruar të mbajnë një rryp toke të lirë me gjerësi 4m nga çdo anë e bazamenteve të pikave mbështetëse.

(6) Në zonën mbrojtëse të linjës ajrore ndalohet:

a) vendosja e ndërtimeve apo vendosja e kontruksioneve dhe e të tjera pajisjeve të ngjashme, si dhe depozitimi i lëndëve djegëse apo plasëse;

b) mbjellja e bimësisë dhe lënia e rritjes së tyre mbi lartësinë 3 metra;

c) të kryhen veprimtari që rrezikojnë linjën ajrore, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e funksionit të tyre ose jetën, shëndetin dhe pasurinë e personave.

(7) Zona mbrojtëse e linjës nëntokësore deri 110 kV përfshirë dhe linjat e komandimit, matjes dhe teknikës së mbrojtjes shtrihet 1 m nga të dy anët e kabllit anësor, mbi 110 kV shtrihet 3 m nga të dy anët e kabllit anësor.

(8) Në zonën mbrojtëse të linjës nëntokësore ndalohet:

a) kryerja e punimeve tokësore (gërmime) pa pëlqimin e pronarit të saj;

b) vendosja e ndërtimeve apo vendosja e konstruksioneve ose pajisjeve të tjera të ngjashme dhe kryerja e veprimtarive të cilat do të pamundësonin ose pengonin mundësinë e hyrjes te linja nëntokësore, apo të cilat do të mund të rrezikonin sigurinë e qëndrueshmërinë e funksionimit të saj;

c) mbjellja e bimësisë së vazhdueshme dhe kalimi sipër linjës me mekanizma me pesha totale mbi 3 ton.

(9) Zona mbrojtëse e stacionit elektrik kufizohet nga plane pingule në distancë horizontale 30 m perpendikular ndaj kufirit ose murit rrethues të objektit të stacionit.

(10) Në zonën mbrojtëse të stacionit elektrik ndalohet kryerja e veprimtarive, të cilat mund të kenë si pasojë rrezik jete, shëndeti apo pasurinë e personave, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e punimit të stacionit, ose që pamundësojnë ose vështirësojnë tepër mirëmbajtjen e tij.

(11) Personat fizikë a juridikë, që drejtojnë pajisje të ushqyera me rrymë të vazhduar në afërsi të drejtpërdrejtë të zonës mbrojtëse, me mundësi shfaqje të rrymave parazitare që dëmtojnë linjën nëntokësore, janë të detyruar që këtë t’ia njoftojnë furnizuesit dhe të marrin masa për kufizimin e tyre.

(12) Për mbrojtjen e centraleve prodhuese të energjisë elektrike zbatohen vendimet e paragrafit 9 dhe 10.

(13) Përjashtimet nga zonat mbrojtëse lejohen vetëm në raste të veçanta nga Enti i Rregullimit.

Neni 15

Çvendosja e pajisjeve shpërndarëse

(1) Çvendosja e pajisjeve shpërndarëse për qëllimet e këtij ligji, kuptohet ndryshimi pjesor i trasesë së linjës apo çvendosja e disa elementëve të kësaj pajisjeje.

(2) Çvendosjen e pajisjes shpërndarëse e siguron pronari i saj me shpenzimet e atij që e kërkon këtë çvendosje.

(3) Pronësia e pajisjes shpërndarëse pas kryerjes së çvendosjes nuk ndryshon.

Neni 16

Kryqëzimi i linjave elektrike me pajisje të tjera

Gjatë kryqëzimit të linjave elektrike me pajisjet e komunikacionit, rrjedhjet ujrore, hekurudha e pajisje të tjera të çdo lloji, pronarët apo shfrytëzuesit e linjave elektrike janë të detyruar që në bashkëpunim reciprok të marrin masa teknike për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së punimit të tyre dhe për mundësinë e mirëmbajtjes së rregullt.

Neni 17

Marrja e parregullt e energjisë elektrike

- (1) Marrje e parregullt e energjisë elektrike është:
- a) marrja pa lidhje kontrate;
 - b) marrja nga ajo pjesë e pajisjes, nëpër të cilën kalon energji e pamatur;
 - c) marrja pa pajisje matëse ose me pajisje matëse, që si pasojë e ndërhyrjes së përdoruesit marrja ose nuk regjistrohet ose regjistrohet më e vogël se realiteti;
 - ç) marrja me pajisje matëse, të cilën nuk e ka lidhur furnizuesi apo tek e cila është prishur sigurimi ndaj ndërhyrjeve të parregullta.
- (2) Mënyra e llogaritjes së dëmit të shkaktuar furnizuesit nga marrja e parregullt si dhe sanksionet përkatëse caktohen nga Enti i Rregullimit sipas dispozitave në fuqi.

PJESA E KATËRT

Neni 18

Dispozita tranzitore

- (1) Kur në këtë ligj nuk është vendosur ndryshe, për vendosjen e të drejtave e detyrave të personave fizikë e juridikë, veprohet sipas legjislacionit në fuqi.
- (2) E drejta ndaj pasurive të paluajtshme të sektorit të energjisë elektrike si dhe kufizimi i përdorimit të tyre, që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten të paprekura.
- (3) Zonat mbrojtëse të vendosura sipas rregullave të deritanishme dhe përjashtimet nga vendimet mbi zonat mbrojtëse sipas rregullave të derisotme, ruhen edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- (4) Këshilli i Ministrave, Ministria dhe Enti i Rregullimit nxjerr aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 19

Çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 1161, datë 31.7.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**